



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 52 Prot.

Tiranë, më 10. 01. 2018

V E N D I M

Nr. 10, Datë 10. 01. 2018

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është paraqitur ankesa Nr. 74, datë 02.08.2017, e shtetasve A. A. dhe I. A., kundër Bashkisë Berat, me pretendim diskriminimin për shkak të racës.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

A. A. dhe I. A. pretendojnë se: *“Në lagjen Stan-Moravë, janë lënë përgjysëm pastrimi i kanaleve të ujitjes dhe për pasojë sipërfaqet e mbjella nuk mund të vaditen. E kemi ngritur këtë problem edhe për kanalizimet e ujërave të zeza. Duke qënë se kanalet janë bllokuar aktualisht, në to janë grumbulluar papastërti dhe janë bërë burim infeksionesh. E kemi ngritur kudo këtë problem, por nuk kemi gjetur zgjidhje.”*

Në këto kushte, ankuesi kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi: *“Kërkojmë pastrimin e kanaleve të vaditjes.”*

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ndërmori hapat proceduralë si më poshtë vijojnë :

Pas analizimit të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vijoi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Me anë të shkresës nr. 776/1 prot., datë 15.08.2017, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, iu drejtua Institucionit të Bashkisë Berat, në të cilën kërkoi informacion mbi pretendimet e subjektit ankues.

- Në mbështetje të pretendimeve të ankuesve, Bashkia Berat nuk vuri në dispozicion të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi asnjë informacion.

2. Përsa më lart, mbështetur në Urdhërin nr. 134, datë 06.10.2017 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi “Për kryerjen e inspektimit pranë Bashkisë Berat, me qëllim marrjen e informacionit, lidhur me ankesën nr. 74, datë 02.08.2017”, më datë 12.10.2017, inspektorët e KMD-së u paraqitën pranë Bashkisë Berat, për të kryer verifikimet përkatëse mbi çështjen në fjalë.

Gjatë inspektimit pranë Bashkisë Berat, inspektorët e KMD-së, morën takim me E. D., me detyrë Specialist-Jurist pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Ujrave dhe Shërbimit Veterinar.

Në vijim të inspektimit, E. D., informoi se: *“Pastrimi i kanaleve të ujitjes dhe të kullimit në të gjithë territorin që mbulon Bashkia Berat, kanë nisur në muajin Prill 2017 dhe kanë përfunduar në muajin Qershor 2017. Referuar Planifikimit¹ të Punës së Kullimit për vitin 2017, në zonën e kanalit të ujitjes në Moravë, janë pastruar nga ana jonë 2.5 km gjatësi e këtij kanali. Kjo punë ka përfunduar deri në muajin Qershor 2017, referuar edhe ligjit nr. 24/2017 “Për ujitjen dhe kullimin”.*

Gjithashtu, në dispozicion të KMD-së u paraqit përgjigjia² e Drejtorisë së Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Ujrave dhe Shërbimit Veterinar, me nr. 618/1 prot., datë 25.08.2017, si dhe Planifikimi i Punës së Kullimit për vitin 2017.

3. Në vijim të procedurave hetimore, inspektorët e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, u paraqitën më datë 12.10.2017, në lagjien Stan-Moravë të Beratit dhe morën takim me I. A.

¹ Dokument i hartuar nëpërmjet së cilit evidentohet plani i punës për pastrimin e kanaleve të vaditjes.

² Në përgjigje të shkresës së KMD-së nr. 776/1 prot., datë 15.08.2017

Gjatë takimit me I. A., nga ana e tij u sqarua se: “...*Që prej vitit 1995, kanali vaditës përpara banesës sime është mbushur me inerte dhe nuk ka funksionuar që prej asaj kohe. Nga ana e Bashkisë Berat, është bërë pastrim i kanaleve të vaditëse, por jo kanali përpara banesës për të cilin kam paraqitur ankesë tek Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.*”

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Për sa më sipër, gjatë procesit të hetimit, pas shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ankuesi dhe palët kundrejt së cilës drejtohej ankimi, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatoi :

Së pari, sipas informacionit të administruar dhe shkresës nr. 618/1 prot., datë 25.08.2017 të Bashkisë Berat, në periudhën Prill-Qershor 2017, kanalet ujitëse të lagjjes Stan-Moravë dhe të të gjithë fshatit Moravë, janë pastruar nga ana e Drejtorisë së Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Ujrave dhe Shërbimit Veterinar, me mjetet që Bashkia Berat disponon. Në ato pjesë që mjeti nuk ka patur mundësi të ndërhyjë, kanalet janë pastruar me mjete alternative: si pastrime me krahë ose gjetjen e një mjeti tjetër më të përshtatshëm.

Për sa më sipër, gjykojmë dhe vlerësojmë se kërkesa e subjekteve ankuese është plotësuar, përsa i përket kanaleve të ujitjes të cilat ekzistojnë dhe kanë qënë në gjendje pune.

Në përfundim, pretendimet e subjekteve ankuese se raca është bërë shkak për trajtimin në mënyrë të pabarabartë dhe të padrejtë, nga ana e Bashkisë Berat, duke mos bërë pastrimin e kanaleve të ujitjes në lagjjen Stan-Moravë, nuk mbështetet në asnjë nga provat dhe faktet e administruara nga Komisioneri gjatë procedurave hetimore.

Së dyti, lidhur me kanalin e ujitjes për të cilin I. A. ngriti pretendime në takimin e datës 12.10.2017, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk ka kompetencë të vijojë procedurën e shqyrtimit të këtij pretendimi, pasi sipas informacionit të dhënë prej tij, kanali nuk ka qënë funksional që prej vitit 1995.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/d), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku citohet se: “**Ankesa nuk pranohet nëse të gjitha faktet që përbëjnë thelbin e ankesës kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të këtij ligji**” dhe pikës dh) të këtij neni, që parashikon se: “**Ankesa nuk pranohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se një vit nga marrja dijeni nga i dëmtuari, për këtë fakt**”, **ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.**

PËR KËTO ARSYE:

Nga shqyrtimi i kësaj ankese dhe bazuar në nenin 33, pika 4/d/dh e Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mosdiskriminimin e subjekteve ankuese, nga ana e Bashkisë Berat, për shkak të racës, lidhur me pastrimin e kanaleve të ujitjes të lagjjes Stan-Moravë.
2. Mospranimin e ankesës së subjekteve ankuese, lidhur me pastrimin e kanalit ujitës përpara banesës së I. A., për shkak se është e papajtueshme me dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

KOMISIONERI

Irma BARAKU

(Shkaku: Raca)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)